

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I PARË

VENDIM

Ankimi nr. 74941/14

Kleopatra CAKA

kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë) e mbledhur më 24 janar 2017, si një Komitet i përbërë nga:

Kristina Pardalos, Kryetare

Pauliine Koskelo,

Tim Eicke, gjykatës,

dhe Renata Degener, Zëvendës Regjistrare e Seksionit,

Në lidhje me ankimin e mësipërm të paraqitur më 18 nëntor 2014,

Në lidhje me deklaratat formale, të cilat pranonin një zgjidhje miqësore të çështjes,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë vijon:

FAKTE DHE PROCEDURA

Ankuesja, zj. Kleopatra Caka, është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1963 dhe jeton në Tiranë. Ajo u përfaqësua përpara Gjykatës nga z. F. Caka, avokat i cili ushtron profesionin në Tiranë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentja e saj, zj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

Ankuesja ankohej se kishte pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, për moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, dhënë në favorin e saj, në të cilin urdhërohej pagesa e dëmeve si rezultat i pushimit të saj të padrejtë nga puna.

Më 22 shtator dhe 3 nëntor 2016, Gjykata mori deklaratë për zgjidhje miqësore të firmosura nga palët, sipas së cilave ankuesja ishte dakord të hiqte dorë nga kërkesa të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që çuan në këtë ankim kundër Shqipërisë kundër një mase të marrë nga Qeveria për t’i paguar asaj EUR 10,400 (dhjetë mijë e katërqind euro) për të mbuluar çdo dëm monetar dhe jomonetar si edhe kostot dhe shpenzimet, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe nuk do të preken nga asnjë taksë e cila mund të jetë e zbatueshme. Kjo shumë do të paguhet brenda tre muajve nga data kur njoftohet vendimi i marrë nga Gjykata. Në rast se shuma e mësipërme nuk paguhet brenda një periudhe tre-mujore, Qeveria merr përsipër që të paguajë një interes të thjeshtë për të, që nga momenti kur kjo periudhë përfundon deri në shlyerjen e saj, në një normë të barabartë me normën marginale të huasë të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus pikë tre përqindëshe. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

LIGJI

Gjykata merr parasysh marrëveshjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo është siguruar se marrëveshja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut siç përcaktohet në Konventë dhe në Protokollin e saj, dhe nuk gjen asnjë arsye për të justifikuar një shqyrtim të vazhduar të ankimit. Bazuar në sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime,

Vendos ta përjashtojë ankimin nga lista e saj e çështjeve bazuar në nenin 39 të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 16 shkurt 2017.

Renata Degener
Zëvendës Regjistrare

Kristina Pardalos
Kryetare